

Mars 2020



Ekspertët e Mazars në Shqipëri kanë përgatitur buletin informativ të rradhës në lidhje me masat ekonomike, fiskale dhe ligjore të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për përballimin e situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19.

Masa te karakterit fiskal

Si pjese e paketes “Anti COVID-19”, parashikohet sa më poshtë:

Shtyrja e afateve të dorëzimit të Bilancit Kontabël

Afati i dorëzimit të Bilancit Kontabël të vitit financiar 2019, së bashku me anekset e tij shtyhet deri në datën 31 korrik 2020. Ndërkohë data e dorëzimit të deklaratës vjetore të tatim fitimit të vitit fiskal 2019 mbetet data 31 mars 2020.

Masa lehtësuese për entitetet me qarkullim nën 14 milion lekë subjekt i tatim fitimit

Për bizneset me qarkullim deri në 14 milion lekë, subjekt i tatim fitimit, janë parashikuar lehtësitë e mëposhtme fiskale:

1. Tatim fitimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të tatim fitimit të vitit 2019 do të paguhet brënda gjashtë mujorit të dytë të vitit 2020; në vënd të datës 31 mars që ishte e parashikuar përpara këtij ndryshimi.
2. Afati i pagesës së kësteve të tatim fitimit për të katërt tremujoret e vitit 2020 do të jetë 31 dhjetori 2020.

Pagesat e kësteve të tatim fitimit në kushte normale, përpara këtij ndryshimi, do të kryheshin si më poshtë:

- 30 mars - tremujori parë i vitit 2020;
- 30 qershor - tremujori dytë i vitit 2020;
- 30 shtator - tremujori i tretë i vitit 2020;
- 30 dhjetor - tremujori i katërt i vitit 2020;

Burimi: Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.10, datë 26.03.2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.

Masa të karakterit të përgjithshëm ekonomik

Paketa ekonomike "Anti COVID-19" si ndihmë për bizneset dhe individët

1. Akordimi i një fondi prej 6.5 miliardë lekë në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi, dhe konkretisht do të lëvrohet:
 - për shtresat në nevojë;
 - për të papunët, si rrjedhojë e situatës aktuale;
 - për mbështetje të ndryshme të komuniteteve dhe sektorëve, që do të rezultojnë më të dëmtuarit, për shkak të situatës aktuale.
2. Akordimin e një fondi prej 2.5 miliardë lekë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i cili ka për qëllim financimin e shpenzimeve, korente dhe kapitale, të sektorit shëndetësor, për furnizimin me medikamente, aparatura dhe urgjenca të ndryshme dhe në mbështetje të stafeve mjekësore.
3. Rialokimin brenda Ministrisë së Mbrojtjes të një fondi prej 2 miliardë lekë i cili do të përdoret për:
 - furnizimin me ushqim të komuniteteve të caktuara që do të rezultojnë të prekura nga pandemia, apo për familje me ndihmë ekonomike dhe pensionistë të vetmuar që do të kene nevojë për ndihmë direkte;
 - plotësimin e nevojave të ekipeve mjekësore, si në spitalet civile ashtu edhe në spitalin ushtarak.
4. Rritjen me 1 miliardë lekë të Fondit Rezervë të buxhetit të shtetit, me qëllim përballimin e shpenzimeve të domosdoshme me karakter të paparashikuar.
5. Mbeshtetje per biznesin, ne formen e instrumentit të Garancisë Sovrane në masën 11 miliardë lekë e cila do të vendoset si garanci për shoqëritë që do të gjenden përballë vështirësisë për pagesën e pagave të punonjësve gjatë këtyre muajve.
6. Amnesti të kamatvonesave të shkaktuara si rezultat i mospagimit në kohë të detyrimeve të energjisë elektrike. Kamatvonesat e fshira kapin një vlerë prej 150 milion dollar dhe nga kjo pritet të përftojnë rreth 220 mijë abonent në të gjithë Shqipërinë.

Në total, shpenzimet e buxhetit të vitit 2020 shtohen me një total prej 2 500 milion lekë (ose 250 milion \$) e cila konsiderohet si paketa "Anti COVID-19".

Burimi: Akt Normativ i Këshillit të Ministrave Nr.6, datë 21.03.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020".

Buletin Informativ

Shtyrje e afatit të pagesave të kësteve të kredive

Bazuar në Urdhrin e Përbashkët të Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë të datës 17 mars 2020, lejohet shtyrja e afatit të pagimit të kësteve të kredisë për bizneset dhe individët deri në datën 31.05.2020. Më konkretisht:

- Shtyhet afati i pagimit të kësteve të kredisë për bizneset dhe individët deri në datën 31.05.2020 për të gjithë ata kredimarrës, të cilët janë përballur me vështirësi në këtë periudhë si pasojë e COVID-19.
- Kredimarrësit duhet komunikojnë me kredidhënësit (banka, institucione financiare jobanka apo me shoqëritë e kursim-kredive) duke u argumentuar këtyre të fundit arsyet mbi nevojat e tyre për shtyrje të pagimit të kësteve.
- Institucionet e kreditimit do të bëjnë procesimin e çdo kërkesë të paraqitur pranë tyre brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Kujdes! Ky proces parashikon shtyrje te pagesave por jo falje te tyre.

Burimi: Urdhër i përbashkët i Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, datë 17.03.2020.

Masa te karakterit ligjor

Me Urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- Mbyllen institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar të vendit deri në datën 3 prill 2020. Moszbatimi i këtij urdhëri sjell gjobitje nga 1.000.000-5.000.000 Lek.
- Mbyllen baret, restorantet, fast food, lokalet që ofrojnë shërbim për klientët. në të gjithë vendin, deri në datën 3.04.2020. Përjashtim nga ky rregull i përcaktuar bëhet vetëm për shërbimin në banesë (delivery). Çdo subjekt në kundërshtim me këtë urdhër, gjobitet me 1,000,000 Lek deri me mbyllje aktiviteti në rast përsëritjeje.
- Bizneset të cilat nuk mund të mbyllin aktivitetin e tyre si rezultat i zinxhirit ekonomik duhet të sigurojnë distancën prej 1.5m të stafit si dhe ti pajisin ata me pajisjet mbrojtëse për të garantuar shëndetin e tyre.
- Bizneset Call Centre-s duhet të reduktojnë sa të mundën stafin në vëndin e punës si dhe të marrin masa mbrojtëse për kujdesin e shëndetit të punonjësve.
- Institucionet publike dhe private, të hartojnë një plan masash për sigurimin e ofrimit të shërbimeve prioritare, duke prioritetizuar kategoritë e shërbimit kryesisht nëpërmjet ofrimit të shërbimit online, punës në distancë, dhe vetëm në raste të domosdoshme të ofrojnë shërbimin ndërmjet kontaktit fizik.
- Kufizohen daljet e individëve në fasha të caktuara orare. Moszbatimi i këtij rregulli është subjekt gjobe prej 10 mije Lek.

Me Urdhër të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës:

- Pezullohen linjat ajrore dhe detare me të gjithë aeroportet dhe portet e Italisë deri në një njoftim të dytë.
- Pezullohen linjat ajrore me Mbretërinë e Bashkuar deri në një njoftim të dytë.
- Pezullohen linjat ajrore, detare dhe tokësore me Greqinë deri në një njoftim të dytë.
- Pezullohen të gjitha linjat ajrore me përjashtim të fluturimeve të AirAlbania me Stambollin.

Sipas njoftimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:

Buletin Informativ

Të gjithë subjektet prodhuese dhe sipërmarrjet e shërbimit, që nuk hyjnë në listën e aktiviteteve të ndaluara, duhet të marrin masa që të sigurojnë transportin e punonjësve të tyre. Kjo mund të kryhet ose duke vënë në dispozicion autobusë të akredituar nga Policia e Shtetit përmes email-it te adresa e policisë së shtetit policiarrugore@gmail.com, policiarrugore@asp.gov.al ose duke akredituar mjetet personale të punonjësve të tyre.

Përmbajtja e email-it që duhet të dërgohet duhet të jetë si më poshtë:

- Emri dhe mbiemri i punonjësve;
- Targa e autobusit me të cilin do të qarkullojnë punonjësit;
- Targa e makinës së punonjësit që do të lëviz me mjet privat;
- Vendi i punës ku do të shkojnë;
- Orari i lëvizjes;

Në këto automjete, punonjësit duhet të pajisen me mjete mbrojtëse si doreza, maska dhe dizinfektant.

Për më shumë detaje lutemi ti referoheni linkut më poshtë:

<https://www.asp.gov.al/covid-19-vetedeklaro-levizjen-me-automjet/>

Burimi: Urdhëra dhe Udhëzime të publikuara nga Ministrinë e Linjës.

Buletin Informativ

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889

E-mail: info@mazars.al